

VENDIM
Nr. 871, datë 12.12.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ndërmjet programeve, si më poshtë:

a) Në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, në zërin “Investime kapitale të brendshme” (TVSH, taksë doganore), të shtohet fondi prej 13 800 000 (trembëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekësh.

b) Në programin “Mbështetje për burimet natyrore”, në zërin “Investime kapitale të brendshme”, të shtohet fondi prej 8 000 000 (tetë milionë) lekësh.

c) Kjo shumë të përballohet nga pakësimet e fondeve në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, në vlerën 21 800 000 (njëzet e një milionë e tetëqind mijë) lekë, në të njëjtin zë shpenzimesh.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha